



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 678, Datë 13.02.2020

**“Mbi miratimin e Udhëzimit “Për praktikat më të mira për kryerjen e procedurave në lidhje me zbatimin e nenit 4 dhe 9 të ligjit nr.9121, "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar””**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 13.02.2020, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Mbi miratimin e Udhëzimit “Për praktikat më të mira për kryerjen e procedurave në lidhje me zbatimin e nenit 4 dhe 9 të ligjit nr.9121, "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar”

**Baza Ligjore:** Nenet 24, shkronja dh), të Ligjit 9121/2003 ‘Për Mbrojtjen e Konkurrencës’, i ndryshuar;

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

**VËREN SE :**

1. Udhëzimi parashikon rregulla praktike mbi procedurat e Autoritetit të Konkurrencës, duke synuar dhe siguruar një zbatim efektiv të rregullave të konkurrencës dhe njëkohësisht respektimin e të drejtave themelore të mbrojtjes.
2. Udhëzimi përcakton parimet mbi të cilat mbështetet veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës duke parasysh parimet e ligjshmërisë, transparencës, të drejtës së informimit, konfidencialitetit, proporcionalitetit, drejtësisë, paanësisë, objektivitetit, jo-diskriminimit, të përcaktuara në ligjin nr.9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar, por edhe në Kodin e Procedurave Administrative.

3. Udhëzimi parashikon rregulla praktike mbi procedurat e Autoritetit të Konkurrencës.

**PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja dh), të Ligjit 9121/2003 ‘Për Mbrojtjen e Konkurrencës’, i ndryshuar,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Udhëzimit “Për praktikat më të mira për kryerjen e procedurave në lidhje me zbatimin e nenit 4 dhe 9 të ligjit nr.9121, "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar””.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**